



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A NR. 145/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Bosnjacka Unija Kosova (BUK) me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të mëparshëm të KZAP-it Anr. 87/2010 datë 23.02.2010, për rishqyrtimin te vendimit, në seancën e panelit të mbajtur me 19.04.2010, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli për rishqyrtim.

A R S Y E T I M I

Subjekti politik Bosnjacka Unija Kosova (BUK) me seli në Prizren, më datë 22.03.2010 ka parashtruar një apel për rishikim të vendimit të mëparshëm të KZAP-it A nr.87/2010 datë 23.02.2010, për shkak të mos deklarimit të Raportit Financiar dhe është dënuar më 1500 euro. Parashtruesi i apelit thekson se nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk është dhënë asnjë përkrahje për këtë subjekt politik ne lidhje me menaxhimin e financave edhe pse kjo është e obliguar me nenin 40.7 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). BUK është subjekt i ri politik që për herë të parë merr pjesë në zgjedhje, nuk ka përvojë ne fushën e financave, po ashtu BUK nuk ka marrë asnjë instruksion nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), nuk ka marrë formularët e nevojshëm në bazë të cilëve kishte mundur te paraqet raportin financiar në afat ligjor.

Parashtruesi i apelit, propozon qe te rishqyrtohet vendimi i marrë A nr.87/2010 datë 23.02.2010, të anulohet vendimi i mëparshëm i KZAP-it dhe ankesën e parashtruar nga ZRPPC-ja ta refuzoj si te pabazuar.

F A K T E T

Më 22.03.2010, KZAP-i ka pranuar një apel me shkrim nga subjekti politik BUK, në të cilin theksohet se ky subjekt politik nuk ka qenë i informuar me procedurat se si bëhet deklarimi i raportit financiar. Parashtruesi i apelit konsideron se kur është përcaktuar gjoha nuk është marrë asnjë rrethanë lehtësuese të cilat do të kishin ndikim në vendimmarrje ngase ky subjekt politik është iniciativë qytetare dhe përfaqëson pjesën e etnitetit Boshnjak andaj edhe konsiderojmë se shqiptimi i gjobës në këtë mënyrë do te dekurajoj këtë subjekt politik të tërhiqet nga jeta e mëtejshme politike.

Vendimi i KZAP-it ishte marrë në bazë të Nenit 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Në këtë kontekst, subjekti politik BUK ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Parë (I) të zgjedhjeve, jo më vonë se 31.12.2010 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj pretendimet e ankimore janë të bazuara.

Neni 120.1, pika c) - (Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve) të LZP-së, përcakton se: në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizatë vëzhguese në një vlerë deri në dyqind mijë euro (€ 200,000).

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, KZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; dhe
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore të tij;
- Ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese ose rënduese.

Duke u bazuar në nenin 118.1 të LZP i cili përcakton se: KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet.

Prandaj, me rastin e apelit kundër vendimit të mëparshëm të KZAP-it, A nr.87/2010 datë 23.02.2010 i parashtruar nga subjekti politik BUK në të cilin kërkohet që të rishqyrtohet vendimi i KZAP-it A nr. 87/2010 datë 23.02.2010, apeli për rishqyrtim refuzohet si i pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 145/2010 më datën 19.04.2010

Kryesuesi i Panelit

